
L I G J
Nr.8752, datë 26.3.2001

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE
MBROJTJEN E TOKËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë strukturat pranë organeve të qeverisjes vendore për ruajtjen dhe administrimin e tokës.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrim" kuptohen proceset e përcaktimit, të dokumentimit dhe të propagandimit të të dhënave për pronësinë, për vlerën dhe përdorimin e tokës gjatë vënies në zbatim të politikave të menaxhimit të saj.
2. "Menaxhim" kuptohen veprimtaritë e lidhura me përdorimin e tokës si një burim me vlera mjedisore dhe ekonomike.
3. "Kadastër shumë qëllimshme" kuptohet një regjistër që përfshin shumë attribute të parcelave të tokës.
4. "Tokë" ka të njëjtin kuptim si toka bujqësore në ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".
5. "Tokë pyjore dhe pyll" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7623, datë 13.10.1995 "Për pyjet dhe Policinë Pyjore".
6. "Kullotë dhe livadh" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7917, datë 13.4.1995 "Për kullotat dhe livadhet".
7. "Breg" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore".
8. "Varësi teknike" kuptohet detyrimi i strukturave të përcaktuara në këtë ligj për të zbatuar aktet nënligjore të miratuara nga organet eprorë.
9. "Të dhëna përshkruese" kuptohen libra ngastrash dhe regjistra të ndryshëm.
10. "GIS" është Sistemi i Informacionit Gjeografik.
11. "Tokë e pafrytshme" kuptohet toka cilësisht e dobët që nuk përfshihet në zërat kadastralë: tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, kullota, livadhe e troje.
12. "Mbrojtje toke" kuptohet mbrojtja fizike dhe e pjellorisë së tokës nga erozioni, ndotja dhe degradimi.

KREU II

ORGANIZIMI

Neni 3

Për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, pranë Këshillit të Qarkut krijohet Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës si funksion i deleguar i Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Numri i punonjësve dhe mënyra e funksionimit të Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Përgjegjësi i Seksionit dhe specialistët emërohen dhe shkarkohen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil".

Neni 6

Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës, si funksion i tyre sipas përcaktimit në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", në çdo komunë dhe/ose bashki ngrihet zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës.

Neni 7

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në bashki dhe/ose komunë kanë varësi teknike nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit nxjerr akte nënligjore në zbatim të këtij ligji për drejtimin metodik dhe teknik të administrimit dhe menaxhimit të tokës, si dhe kontrollon zbatimin e tyre.

Neni 8

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në bashki dhe/ose komunë për realizimin e detyrave të ngarkuara nga ky ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, përgjigjen përkatësisht para Këshillit të Qarkut, Këshillit të Komunës ose Bashkisë.

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark bashkëpunon dhe shkëmben të dhëna me seksionin ose zyrën e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki.

KREU III

OBJEKTI DHE FUNKSIONET

Neni 9

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark, administron dhe merr masa për mbrojtjen e tokës brenda ndarjes administrative territoriale të qarkut, siç

përcaktohet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 10

Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës menaxhon dhe merr masa për mbrojtjen e tokës në territorin brenda ndarjes administrative territoriale të komunës dhe/ose bashkisë.

Neni 11

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki kanë në administrim:

- a) tokat bujqësore shtetërore, që me ligj i vihen në administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;
- b) tokat bujqësore private;
- c) pyjet komunale dhe private;
- ç) kullotat komunale dhe private;
- d) tokat pyjore shtetëror, që me ligj i vihen në administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;
- dh) brigjet e lumenjve, që me ligj i vihen në administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;
- e) tokat urbane të fshatit;
- ë) tokat e pafrytshme.

Neni 12

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut për tokat që ka nën administrim, si kadastër shumë qëllimshme, kryen këto funksione:

- a) Bën planifikimin e përdorimit të tokës, ndryshimin ndërmjet zërave kadastralë dhe drejton hartimin e planeve të zhvillimit.
 - b) Në bashkëpunim me institucionet e specializuara përgatit, ruan dhe azhurnon informacionin gjeografik në format e hartave, të dhënave përshtetëse dhe GIS.
 - c) Organizon dhe merr masa në bashkëpunim me komunat dhe bashkitë për zbatimin e programeve dhe masave mbrojtëse për ruajtjen fizike dhe të pjellorisë së tokës, nga erozioni, ndotja dhe degradimi.
 - ç) Zbaton detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet për mbrojtjen e tokës, në të cilat vendi ynë është palë.
 - d) Mban arkivin dhe regjistrat themeltarë, jep të dhëna dhe kryen veprime në shërbim të personave fizikë dhe juridikë.
 - dh) Bën vlerësimin e tokës bujqësore, pyjore, pyjeve, livadheve dhe kullotave që do të shërbejë për qëllime shpronësimi, taksa e tatime.
- Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të parashikuara në këtë nen përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Seksioni ose zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës kryen këto funksione:

- a) Përgatit procedurën dhe ia paraqet për miratim këshillit të komunës dhe/ose bashkisë për qiradhënien, dhënien me koncesion, lejeve të shfrytëzimit ose formave të tjera të transferimit të të drejtave të parashikuara me akte ligjore e nënligjore të pyjeve dhe kullotave komunale, të tokave bujqësore shtetërore, tokave pyjore, brigjeve të

lumenjve, që me ligj i kalojnë në pronësi ose administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë.

b) Grumbullon informacionin gjeografik dhe ruan hartat dhe dokumentacionin që ka në varësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) Merr masa mbrojtëse për ruajtjen fizike dhe të pjellorisë së tokës nga erozioni, ndotja dhe degradimi.

Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të parashikuara në këtë nen përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

SANKSIONE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Mosmarrja e masave mbrojtëse ose moszbatimi i tyre për dëmtimet fizike, për dëmtimet e pjellorisë nga erozioni, ndotja dhe degradimi, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri 50 000 lekë nga specialisti i mbrojtjes së tokës në seksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", pa përfshirë vlerën e dëmit.

Neni 15

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të kryetari i këshillit të qarkut, i cili shqyrton ankesën dhe jep vendimin brenda 5 ditëve.

Neni 16

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të vendimit bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 4, 12 dhe 13 të këtij ligji.

Neni 18

Nenet 17, 20 dhe 24 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2953, date 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Rexhep Meidani

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 8752, DATË 26.3.2001 "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKËS"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore, emërtimi "Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës" zëvendësohet me emërtimin "Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT)".

Neni 2

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë:

- a) rregullat themelore të administrimit të tokës bujqësore, në pronësi private dhe shtetërore dhe të disa prej kategorive të tjera të resurseve;
- b) strukturat shtetërore pranë qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tokës, si dhe funksionet e detyrat e tyre."

Neni 3

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. "Tokë bujqësore" ka kuptimin sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 2 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

2. Në pikën 5 fjalët "në ligjin nr. 7623, datë 13.10.1995 "Për pyjet dhe Policinë Pyjore" zëvendësohen me fjalët "në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar."

3. Në pikën 6 fjalët "në ligjin nr. 7917, datë 13.4.1995 "Për kullotat dhe livadhet" zëvendësohen me fjalët "në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

4. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. "Mbrojtje toke" ka të njëjtin kuptim me përcaktimin e bërë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

5. Pas pikës 12 shtohen pikat 13 e 14 me këtë përmbajtje:

"13. "Funksion i deleguar, i detyrueshëm" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

14. "Kategori të resurseve" janë sipërfaqet e tokave bujqësore, të fondit pyjor, të fondit kullor, sipas përcaktimeve të pikave 4, 5 e 6 të këtij neni, si dhe sipërfaqet e brigjeve të lumenjve, të tokave të pafrytshme dhe të tokave urbane (trojeve).".

Neni 4

Titulli i kreut II "Organizimi" zëvendësohet me titullin "Organizimi i strukturave të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës".

Neni 5

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, pranë këshillit të qarkut krijohet drejtoria e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (DAMT), në përbërje të së cilës janë:

a) sektori i administrimit të tokës, si funksion i deleguar, i detyrueshëm, i Këshillit të Ministrave;

b) inspektorati i mbrojtjes së tokës (IMT) në nivel sektori, si funksion i këshillit të qarkut, që realizohet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

Neni 6

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, emërtimi "Përgjegjësi i seksionit" zëvendësohet me emërtimin "Drejtor i DAMT-së, përgjegjësit e sektorëve".

2. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Në procedurën e emërimit të drejtorit të DAMT-së në qark, në komitetin ad hoc, të krijuar në institucionin e këshillit të qarkut, dy specialistë të njohur nga fusha përkatëse caktohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Kryetari i Këshillit të qarkut emëron drejtorin e DAMT-së pas miratimit paraprak të drejtuesit të strukturës, që mbulon administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Drejtuksi i strukturës, që mbulon administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka të drejtë të kërkojë zëvendësimin e drejtorit të DAMT-së, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën. Në këtë rast, kryetari i këshillit të qarkut fillon procedurat ligjore për shkarkimin e tij, sipas ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Neni 7

Në nenin 6, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki ka varësi teknike nga DAMT-ja e qarkut.".

Neni 8

Në nenin 8, në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët "si dhe strukturës që mbulon administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit."

Neni 9

Titulli i kreut III "Objekti dhe funksionet" zëvendësohet me titullin "Administrimi i tokës dhe funksionet e detyrat e strukturave shtetërore pranë qeverisjes vendore".

Neni 10

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës kryen këto funksione dhe detyra:

a) përgatit dhe ia paraqet për miratim strukturave përgjegjëse të komunës dhe/ose bashkisë kërkesat dhe dokumentacionin e personave fizikë apo juridikë për qiradhënien, për dhënien e lejeve të shfrytëzimit ose për format e tjera të transferimit të të drejtave, të parashikuara me akte ligjore e nënligjore, të tokave bujqësore të pandara dhe të brigjeve të lumenjve, që me ligj i kalojnë në pronësi ose administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;

b) grumbullon informacionin gjeografik dhe ruan hartat e dokumentacionin që ka në varësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të parashikuara në këtë nen përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave."

Neni 11

Neni 10 shfuqizohet.

Neni 12

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 11/1

1. Në tokat bujqësore të kategorisë së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqeve për ndërtime bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme, si më poshtë:

a) rrugët kombëtare dhe rurale, që lidhin qendrat e banuara me njëra-tjetrën;

b) hekurudhat, aeroportet dhe portet detare;

c) për shpim, kërkim dhe shfrytëzim të burimeve të naftës dhe gazit;

ç) hidrocentralet;

d) për varreza publike;

dh) në funksion të mbrojtjes kombëtare;

e) shtesat e sipërfaqeve në territore, pranë objekteve ekzistuese, me karakter ekonomik dhe prodhues, të ndërtuara në mënyrë të ligjshme, por jo më shumë se sipërfaqja ekzistuese, për zgjerim të së njëjtës veprimtari.

Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë.

2. Studimet dhe propozimet për ndërtime, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshirë edhe zgjerimin e vijave kufizuese të qendrave të banuara, përgatiten dhe paraqiten për miratim nga institucioni shtetëror, që mbulon veprimtaritë ndërtimore dhe, në çdo rast, kanë për bazë zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga pika 2 e nenit 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

3. Ndryshimi i tokave bujqësore të kategorive nga V deri në X të bonitetit në kategori të resurseve të tjera, si tokë urbane (truall), si dhe për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore e kariera, bëhet si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 30 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) për sipërfaqe mbi 30 ha, me ligj të veçantë.

4. Kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas, bëhet si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto resurse;

b) për sipërfaqe mbi 1 ha, me miratimin e Këshillit të Ministrave.

5. Kalimi i tokës bujqësore në kategori të tokës së pafrytshme dhe anasjelltas bëhet si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 30 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) për sipërfaqe mbi 30 ha, me ligj të veçantë.

6. Rregullat dhe procedurat për ndryshimet e kategorive të resurseve, sipas pikave 1 deri në 5 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 13

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

1. DAMT-ja mban dhe ruan arkivin me dokumentacionin themelor kadastral, si librat e tokës, librat e ngastrave, planimetritë, hartat kadastrale, topografike dhe dokumente të tjera ekzistuese të arkivit të kadastrës. Në rastet e dëmtimeve fizike të tyre, të shkaktuara nga kohëzgjatja e përdorimit dhe faktorë të tjerë, kjo drejtori merr masa për përtëritjen e tyre, duke siguruar ruajtjen e origjinalit bashkë me kopjen e përtërirë, në mënyrë të përhershme, në arkiv.

2. Kjo drejtori krijon dokumentacionin e ri për administrimin e tokës, nëpërmjet shfrytëzimit të dokumentacionit ekzistues, të dokumentacionit që disponohet nga institucione të tjera shtetërore dhe që përmban informacion për tokën dhe kategoritë e tjera të resurseve, të produkteve që krijohen nga zbatimi i programeve dhe i projekteve, që kanë si objekt tokën bujqësore, nëpërmjet GIS-së, të matjeve të thjeshta, inventarizimeve, rilevimeve topografike, fotografimeve ajrore, pamjeve satelitore etj. Lloji i dokumentacionit kadastral që mbahet e përdoret, në bazë të të cilit kryhen veprimet administrative e ligjore për resurset në juridiksion të qarkut, është unik dhe përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. DAMT-ja përditëson dhe pasqyron në dokumentacionin kadastral:

a) ndryshimet e ndodhura në kategoritë e resurseve, që vijnë si pasojë e ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe strukturave të tjera shtetërore, që kanë tagrin ligjor e kompetencën e ndryshimeve të kategorisë së resurseve;

b) ndryshimet në kategorinë e tokës bujqësore, bashkë me aktin përkatës të strukturës shtetërore, që ka miratuar ndryshimin.

4. DAMT-ja kryen shërbime dhe jep informacione në bazë të dokumentacionit që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni, për institucione shtetërore, si dhe për persona fizikë dhe juridikë për:

a) madhësinë dhe vendndodhjen e ngastrave bazë kadastrale të tokës bujqësore;
b) statusin juridik mbi pronësinë e tokës për të gjitha zonat kadastrale rurale, ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar dhe rezultatet e këtij regjistrimi nuk janë marrë në dorëzim nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP).
Për zonat kadastrale rurale, ku është kryer regjistrimi fillestar dhe rezultatet e këtij regjistrimi janë marrë në dorëzim nga ZVRPP-ja, vërtetimet që kërkohen për statusin juridik të pronësisë mbi tokën bujqësore, në cilësinë e pasurisë së paluajtshme, lëshohen nga ky institucion;

c) kategorinë e tokës bujqësore, sipas studimit të bonitetit;

ç) sipërfaqet në pronësi private të personave fizikë ose juridikë të periudhës para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 108, datë 29.8.1945 "Për reformën agrare", në çdo rast kur për këtë ekzistojnë të dhëna në dokumentacionin që mbahet në arkivin e DAMT-së.

5. Kryerja e shërbimeve dhe dhënia e informacioneve për institucione shtetërore bëhen falas, ndërsa për personat fizikë dhe juridikë bëhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara nga ministri.

Nga fondi financiar vjetor, që krijohet nga këto shërbime, 40 për qind e tij jepet për t'u përdorur për mbulimin e veprimtarive të DAMT-së."

Neni 14

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13

1. DAMT-ja përgatit evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve të kategorive për të gjithë territorin në juridiksion të qarkut, brenda muajit janar të vitit pasardhës.

2. Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë ka për detyrë që, nëpërmjet ZMMT-së, t'i dërgojë DAMT-së evidencën e gjendjes dhe të ndryshimit vjetor të kategorive të resurseve brenda datës 15 janar të vitit pasardhës. Në përgatitjen e të dhënave angazhon edhe zyrën e urbanistikës të komunës dhe/ose bashkisë.

3. Drejtoria rajonale e shërbimit pyjor të qarkut ka për detyrë t'i dërgojë DAMT-së, brenda muajit janar të vitit pasardhës, evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve vjetore të kategorisë së resurseve, në administrim shtetëror, komunal dhe privat, si pyje, tokë pyjore, kullota, livadhe dhe të tjera, objekt i veprimit të ligjeve nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" dhe nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

4. ZVRPP-ja e rrethit, brenda muajit dhjetor të çdo viti, i dërgon DAMT-së pasqyrën e transaksioneve të tokës bujqësore.

5. DAMT-ja detyrohet që, brenda muajit janar të vitit pasardhës, të dërgojë përmbledhësen e evidencës në nivel qarku dhe të nënndarjes (rrethit) në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, e cila, brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, bën përmbledhësen për të gjithë territorin e vendit.

6. DAMT-ja, në mënyrë periodike, detyrohet të dërgojë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit evidenca dhe informacione, që kanë si objekt kategoritë e resurseve të përcaktuara në këtë ligj.

Lloji dhe përmbajtja e tyre përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit."

Neni 15

Titulli i kreut IV "Sanksione dhe dispozita të fundit" zëvendësohet me titullin "Kundërvajtje administrative, sanksione dhe dispozita të fundit".

Neni 16

Pas nenit 13 shtohen nenet 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

"Neni 14

1. Sipas këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

- a) ndërtimet dhe çdo ndryshim i kategorive të tokës bujqësore, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 1 e 2 të nenit 11 të këtij ligji;
- b) mospasqyrimi dhe mospërditësimi në dokumentacionin kadastral të ndryshimeve të kategorive të resurseve dhe të kategorive të tokës bujqësore, si dhe mosdhënia e informacioneve, sipas përcaktimeve të pikave 3 e 4 të nenit 12 të këtij ligji;
- c) mospërgatitja dhe mosdërgimi në kohë i evidencës së gjendjes dhe i ndryshimeve vjetore të kategorisë së resurseve, sipas përcaktimeve të pikave 2, 3, 5 e 6 të nenit 13 të këtij ligji.

2. DAMT-ja e qarkut vendos gjobë:

- a) nga 5 000 deri në 50 000 lekë ndaj çdo subjekti për kundërvajtje administrative, të përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni;
- b) nga 1 000 deri në 10 000 lekë ndaj drejtuesit të ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki për kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në shkronjat "b" e "c" të pikës 1 të këtij neni.

3. Struktura përgjegjëse për administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i vendos gjobë nga 10 000 deri në 20 000 lekë drejtorit të DAMT-së së qarkut për mosveprim, në përmbushje të pikës 2 të këtij neni.

4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i propozon ministrit përgjegjës, që mbulon veprimtarinë për fondin pyjor dhe kullësor në ministrinë përkatëse, vendosjen e gjobës nga 10 000 deri në 20 000 lekë ndaj drejtorit të drejtorisë rajonale të shërbimit pyjor për kundërvajtjet e përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 15

1. Kundërvajtësi, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji, mund të bëjë ankim me shkrim te kryetari i këshillit të qarkut, i cili shqyrton ankimin dhe, brenda 10 ditëve, njofton subjektin ankues.

Kundër vendim it të kryetarit të këshillit të qarkut, subjekti ankues mund t'i drejtohet brenda 30 ditëve gjykatës së rrethit gjyqësor të qarkut.

Ekzekutimi i vendimeve kryhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", të ndryshuar.

2. Drejtori i DAMT-së së qarkut, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji, mund të bëjë ankim me shkrim te Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili e shqyrton ankimin dhe, brenda 10 ditëve, njofton subjektin ankues.

Kundër vendimit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, subjekti ankues mund t'i drejtohet brenda 30 ditëve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor,

Tiranë.

3. Ministri përgjegjës, që mbulon veprimtarinë për fondin pyjor e kullosor në ministrinë përkatëse shqyrton propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vendosjen e gjobës, sipas pikës 4 të nenit 14 të këtij ligji, dhe vendos për ekzekutimin e saj.

Kundërvajtësit mund të ankohen kundër këtij vendimi brenda 30 ditëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.".

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, 12 e 13 të këtij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6501, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM
Nr. 532, date 31.10.2002

PER MENYRAT E USHTRIMIT TE FUNKSIONEVE NGA SEKSIONET E ADMINISTRIMIT DHE TE MBROJTJES SE TOKES NE QARK DHE ZYRAT E MENAXHIMIT DHE TE MBROJTJES SE TOKES NE KOMUNE DHE /OSE BASHKI

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 12 e 13 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Ne zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) "Resurs" nënkupton të gjitha përkufizimet e përdorura në nenin 11 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001.
- b) " Ndryshim " nënkupton ndryshimin e kategorizimit të resurseve të përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi.
- c) "Kategori toke" nënkupton vlerësimin e tokës bujqësore sipas bonitetit.
- ç) "përdorues shtetëror" nënkupton institucionet shtetërore që kanë toke në përdorim.

I. FUNKSIONET DHE DETYRAT E SEKSIONIT TE ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SE TOKES.

1. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark ka për detyrë përcaktimin, dokumentimin dhe publikimin e të dhënave, në formën e hartave e regjistrave, dhe kryerjen e procedurave për ndryshimet, përdorimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e resurseve në juridiksion të qarkut.

2. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark krijon bazën e te dhënave dhe sistemin e te dhënave te kadastrës për njësitë e qeverisjes vendore.
3. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark për resurset ne juridiksion te qarkut, komunës dhe/ose bashkise, mban regjistra dhe harta kadastrale për:
 - a) kategorizimin e resurseve;
 - b) pronësinë e tyre;
 - c) përdorimin e tyre;
 - C) vendndodhjen (pozicionin, kufijtë, koordinatat, madhësinë, pjerrësinë etj);
 - d) treguesit, fizike e kimike;
 - dh) vlerën;
 - e) zonat e dëmtuara ose te rrezikuara nga dëmtimet fizike, erozioni, shkretëtirëzimi, degradimi e ndotja.
4. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark krijon dokumentacionin nga shfrytëzimi i hartave dhe i regjistrave ekzistuese, këmbimi i dokumentacionit falas me zyrat e regjistrimit, drejtoritë e shërbimit pyjor, drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit, seksionet e urbanistikes dhe institucionet e tjera, shtetërore dhe private, qe zotërojnë te dhëna nga matjet e thjeshta, inventarizimet, rivelimet tipografike, fotografitë ajrore, imazhet satelitore etj.
5. Mënyra e mbajtjes se te dhënave ne regjistra përgatitet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, ne bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe te Decentralizimit. Regjistrat te jene te njësuar për te gjitha seksionet e administrimit te tokës ne qarqe dhe te detyrueshme për t'u plotësuar .
6. Për pasqyrimin e treguesve te te dhënave, njësia baze te jete ngastra, prone private dhe publike.
7. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark, ne bashkëpunim me institucionet, private dhe shtetërore, përgatit, përditëson dhe ruan te dhënat gjeografike, ne formën e hartave, për çdo komune dhe/ose bashki, ne juridiksion te qarkut.
8. Hartat e administrimit te tokës te jene te shkalles 1-1000, 1-2500, 1-5000, 1-10000 dhe 1-25000.
9. Kategorizimi i resurseve te jete: toke bujqësore, toke urbane e fshatit (truall), toke pyjore, pyll, kullote, livadh, breg lumi, toke e pafrytshme.
10. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki pasqyrojnë te dhënat për treguesit fizike, kimike dhe te bonitetit te tokave bujqësore.
11. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark shërben si baze lidhjeje për sistemet informatike te specializuara për nevojat qe kane institucionet e ndryshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, kur ato përdorin te dhënat kadastrale.
12. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark kryen shërbime dypalëshe, informacione me zyrën e regjistrimit te pasurive te paluajtshme për ndryshimet e pronësisë dhe bashkimet e parcelave, si rezultat i efektit te tregut te tokës ndryshimet pasqyrohen çdo 6 muaj.
13. Seksioni i administrimit dhe mbrojtës se tokës ne qark u jep te dhëna

kadastrale edhe për elemente të tjerë të administrimit, personave, fizike e juridike, private, kundrejt tarifave të miratuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

14. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark kryen procedurat për ndryshimet e kategorive të tokës, në baza të aktit të organit përkatës, sipas dispozitave në fuqi, dhe bën pasqyrimet përkatëse në regjistrat dhe në hartat.

15. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark kryen procedurat për zbatimin e vendimeve të organeve shtetërore përgjegjëse për kalimet dhe ndryshimet në gjendjen e tokave dhe bën pasqyrimet përkatëse.

16. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark ndjek përditësimet periodike të fondit të tokës dhe kryen veprimet përkatëse në dokumentacion. Në bashkëpunim me institucionet e specializuara, shtetërore ose private, organizon punën për kryerjen e rilevimeve topografike.

17. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në baza të dokumentacionit që merr nga zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki pasqyron çdo 6 muaj të dhënat e fondit të tokës bujqësore, të tokave pyjore e pyjeve, kullotave, livadheve, trojeve, brigjeve të lumenjve dhe tokave të pafrytshme; dhe përmbledhëset e fondit, në shkallë qarku, paraqiten në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit bën përmbledhësen në shkallë republike.

18. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, kryen studime për përdorimin e tokës sipas metodikave të miratuara nga organet përgjegjëse dhe ndjek zbatimin e tyre.

19. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki pasqyrojnë, çdo vit, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe bëjnë përmbledhëset në shkallë komune dhe qarku. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit bën përmbledhësen në shkallë republike.

20. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki, pasqyrojnë, çdo vit, ndryshimet e treguesve, fizike e kimike, të tokës si rezultat i kryerjes së analizave nga zotëruesit, private dhe shtetërore, në laboratorë të certifikuar dhe në bashkëpunim me institucionet e specializuara, në përputhje me metodikat e miratuara nga Instituti i Studimit të Tokave, dhe bëjnë ndryshimet në kategorizimin e tokave sipas bonitetit.

21. Në rastet e dëmtimit të cilësive të tokave, si rezultat i veprimit të faktorëve natyrore, ndryshimi i kategorisë së tokave sipas bonitetit bëhet me miratim të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit. Ndryshimi bëhet me propozimin e seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe në baza të aktvlerësimit zyrtar të Institutit të Studimit të Tokave.

22. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki, në bashkëpunim me institucionet e specializuara kryejnë procedurat për vlerësimin e tokave, për përcaktimin e vlerës, të shpronësimit e taksimit, në baza të metodikave të miratuara për këtë qëllim nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

23. Seksioni i administrimit dhe i mbrojtjes së tokës në qark, në

bashkëpunim me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki, ndjekin dhe mbështesin zbatimin e politikave a te projekteve te miratuara nga organet përkatëse për forcimin e fermave private.

24. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark, ne bashkëpunim me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki, përcaktojnë dëmtimet e tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje. Për shkeljet marrin masa administrative, te përcaktuara sipas ligjit nr .7697, date 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" dhe njoftojnë organet drejtuese te komunës dhe/ose te bashkise e qarkut.

25. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark bashkërendon punën me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki dhe me institucionet e specializuara shtetërore për përcaktimin e zonave te dëmtuara ose te rrezikuara nga dëmtimet, si rezultat i erozionit, shkretëtirëzimit, degradimit e ndotjeve.

26. Seksioni i administrimit dhe i mbrojtjes se tokës ne qark kontrollon zbatimin e projekteve për shfrytëzimin e resurseve nga shoqëritë private. Ne raste shkeljesh, merr masa administrative, te përcaktuara ne ligjin nr. 7697, date 7.4.1993 dhe njofton organet drejtuese te komunës dhe/ose bashkise, qarkut dhe institucionin shtetëror, i cili ka lëshuar licencën e shfrytëzimit.

27. Seksioni i administrimit dhe i mbrojtjes se tokës ne qark bashkëpunon me zyrën e planifikimit te territorit te qarkut për kryerjen e studimeve, për krijimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve urbane ne zonat rurale.

II. FUNKSIONET DHE DETYRAT E ZYRES SE MENAXHIMIT DHE MBROJTJES SE TOKES

1. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki ka për detyre grumbullimin e te dhënave dhe kryen procedurat për shfrytëzimin e resurseve, qe me ligj i kalojnë komunës dhe/ose bashkise.

2. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki kryen studime për përdorimin e resurseve, qe me ligj i kalojnë komunës dhe/ose bashkise. Studimet miratohen nga këshilli i komunës dhe/ose i bashkise.

3. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki ndjek procedurat per dhënien me qira te tokës bujqësore, pyjeve, kullotave, livadheve, tokave pyjore e brigjeve te lumenjve, qe me ligj i kalojnë ne përdorim komunës dhe/ose bashkise.

4. Zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki ndjek zbatimin e projekteve për përdorimin dhe mbrojtjen e tokës, te hartuara nga komuna, qarku ose institucionet shtetërore.

5. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki është përgjegjëse përpara organeve drejtuese te komunës dhe/ose te bashkise për shfrytëzimin e resurseve.

6. Seksionet e administrimit dhe mbrojtjes se tokës ne qark bashkëpunojnë me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokës ne komune dhe/ose bashki dhe me institucionet e specializuara për hartimin e studimeve për përdorimin e tokës .

7. Seksionet e administrimit dhe mbrojtjes se tokës, ne studimet për

përdorimin e tokës, përcaktojnë termat e referencës, mundësitë për ndryshime, vlerësojnë përshtatshmërinë e tokës dhe mundësitë mjedisore, ekonomike e shoqërore.

8. Studimet për përdorimin e tokës, të hartuara nga institucionet e specializuara, nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe nga zyra e menaxhimit dhe e mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki diskutohen për një periudhë 2-mujore në bashkinë e njësive vendore, për të cilat është kryer studimi.

9. Studimet e kryera nga seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit të mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki, përpara miratimit, vlerësohen të pakten nga dy institucione të specializuara, të përcaktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

10. Studimet për përdorimin e tokës, përpara zbatimit, miratohen në këshillin e qarkut.

III. PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN E KATEGORIZIMIT TË RESURSEVE

1. Ndryshimi i kategorisë së tokave pyjore, kullotave, livadheve dhe pyjeve në toke bujqësore, për efekt të zbatimit të normave ligjore përkatëse, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, me propozimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkise dhe këshillit të qarkut, miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

2. Ndryshimi i kategorisë së tokave pyjore, kullotave, livadheve e pyjeve shtetërore në toka bujqësore; c me propozimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkise dhe këshillit të qarkut, miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

3. Ndryshimi i kategorisë së tokave bujqësore, pyjore, kullotave, livadheve e pyjeve në toke truall bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën".

4. Ndryshimi i kategorisë nga toke e pafrytshme me toke bujqësore, toke pyjore, pyll, livadh dhe kullote bëhet me propozimin e këshillit të komunës, dhe/ose bashkise dhe të këshillit të qarkut dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

5. Ndryshimi i kategorisë nga toke bujqësore në toke të pafrytshme, në livadh, kullote, toke pyjore dhe pyll bëhet me propozimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkise dhe të qarkut dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

6. Ndryshimet sipas pikave 1,2,3 dhe 4, të sipërpërmendura bëhen sipas raportit teknik të hartuar nga zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki, nga seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe me Institutin e Studimit të Tokave. Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit harton udhëzim të veçante për ndryshimet, sipas pikave të sipërpërmendura.

IV. PËR MBROJTJEN DHE RIAFTESIMIN E TOKAVE

1. Institucionet shtetërore, që japin licenca shfrytëzimi për resurset, për qëllime jobujqësore, të cilat, me ligj, janë vene në përdorim të qarkut, të komunës dhe/ose bashkise, janë të detyruara të marrin mendimin e këshillit të qarkut, të këshillit të komunës dhe/ose bashkise dhe miratimin

e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

2. Institucionet shtetërore, që japin licenca shfrytëzimi, për qëllime jobujqësore, për tokat bujqësore shtetërore, janë të detyruara të marrin miratimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

3. Kur personi fizik ose juridik, lidh marrëveshje me pronarë private toke, institucioni shtetëror, që jep licence shfrytëzimi, është i detyruar të marrë miratimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkive.

4. Në të gjitha rastet, investitori që shfrytëzon resurset për qëllime jobujqësore është i detyruar t'i kthejë ato në gjendjen e mëparshme, jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i shfrytëzimit.

5. Riaftësimi i resurseve bëhet nga investitori, sipas projekteve të riaftësimit. Projektet e riaftësimit, përpara zbatimit, vlerësohen nga Instituti i Studimit të Tokave dhe miratohen nga institucioni që ka në pronësi ose në përdorim resursin.

6. Vendimi nr. 256, datë 2.8.1991 i Këshillit të Ministrave "Për rregulloren, për regjistrimin, ndryshimin dhe kalimin në gjendjen e tokave dhe detyrat e kadastrës" dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr. 64, datë 23.1.2003

PER PERCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJESVE TË SEKSIONEVE TË ADMINISTRIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKES, NË KESHILLAT E QARQEVË DHE TË ZYRAVE TË MENAXHIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKES, NË KOMUNA DHE/OSE BASHKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, të kenë në përbërje të tyre numrin e punonjësve, të përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë komunave dhe/ose bashkive, të kenë në përbërje një numër punonjësish, të përcaktuar me vendim të këshillit të komunës dhe/ose bashkive, në varësi të sipërfaqes së tokës dhe të kushteve të territorit.

3. Në konkurrimin dhe emërimin e përgjegjësve dhe të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës pranohen dhe caktohen në detyrë vetëm specialiste me profesion agronom, gjeodet, gjeograf dhe ekonomist.

4. Plotësimi i numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të behet brenda organikes vjetore të numrit të punonjësve të këshillave të qarqeve.
5. Punonjësit e strukturave të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të paguhen sipas vendimit nr. 726, date 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".
6. Fondi i pagës së punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të përfshihet në buxhetin vjetor të këshillave të qarqeve, në fondin e kushtëzuar.
7. Fondi i pagës së punonjësve të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë komunave dhe/ose bashkive, të përfshihet brenda buxhetit vjetor të tyre, nga grandi.
8. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.1.2003.
9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

NUMRI I PUNONJESVE TE SEKSIONEVE ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SE TOKES

N/P Emërtimi i Qarkut Numri i
punonjësve Nënndarja
administrative Numri i
punonjësve
KUKES 7
Kukës 3
Has 2
Tropojë 2

VENDIM
Nr.80, datë 28.1.2005

PËR PËRBËRJEN, MËNYRAT E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHETËRORE TË MBROJTJES SË TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

KOMITETI SHTETËROR I MBROJTJES SË TOKËS (KSHMT)

A.I. Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës, si organ ndërministror, ka këtë përbërje:

- Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit kryetar;
- Zëvendësministri i Mjedisit zëvendëskryetar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Financave anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit anëtar;
- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit anëtar;
- Drejtori i Menaxhimit të Tokave, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit anëtar;
- Drejtori i Mbrojtjes së Natyrës, në Ministrinë e Mjedisit anëtar;
- Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit anëtar;

2. Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit të jenë në nivel drejtor drejtorie, veprimtaria funksionale e të cilëve lidhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, me detyrimet, që rrjedhin nga dispozitat e ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 " Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

3. Titullarët e institucioneve përkatëse, brenda muajit janar të çdo viti, të njoftojnë me shkrim Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, me cilësinë e kryetarit të KSHMT-së, për personin e caktuar si përfaqësues të tyre në përbërje të këtij komiteti.

B. Mënyra e funksionimit

1. KSHMT -ja thirret në mbledhje me njoftim të kryetarit, jo më pak se një herë në 6 muaj, por në raste të veçanta, që vlerësohen nga kryetari, mund të mblidhet në çdo kohë.

Në mbledhje të KSHMT-së ftohen të marrin pjesë edhe specialistë të fushës dhe drejtues të

organeve të qeverisjes vendore, sipas çështjeve konkrete që trajtohen.

2. Vendimet në KSHMT merren kur janë të pranishëm më shumë se 50 për qind e anëtarëve

dhe janë të vlefshme kur për to votojnë më shumë se 50 për qind e anëtarëve të pranishëm.

Kur nga votimi rezultojnë vota të barabarta në numër, vota e kryetarit është përcaktuese në marrjen e vendimit.

Ndërmjet dy mbledhjeve të KSHMT -së mund të merren vendime të përkohshme nga kryetari, zëvendëskryetari dhe drejtori i menaxhimit të tokave. Këto vendime paraqiten për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës së KSHMT-së. Kur vendimet e përkohshme nuk miratohen nga KSHMT-ja, ato shfuqizohen me efekte prapavepruese.

3. Roli i sekretariatit të KSHMT -së kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Tokave në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, e cila ka për detyrë përgatitjen e dokumenteve dhe të materialeve të mbledhjeve të KSHMT-së dhe administrimin e akteve, që miratohen nga KSHMT-ja.

C. Detyrat dhe përgjegjësitë

1. KSHMT -ja ka për detyrë bashkërendimin e punëve ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të tjera dhe organeve të qeverisjes vendore, për të gjitha veprimtaritë, që kryhen mbi tokën bujqësore, lidhen me të dhe ndikojnë në mbrojtjen e saj.

2. Veprimtaritë që shqyrtohen dhe bashkërendohen nga KSHMT-ja janë programet dhe projektet afatgjata, afatmesme dhe vjetore, të cilat paraqiten në muajin gusht të çdo viti dhe kanë si objekt:

a) përmirësimin e sistemit të kullimit dhe të ujitjes në hapësirën e tokës bujqësore dhe që

përfshihen në territorin e dy ose më shumë qarqeve;

b) përmirësimin e masave antierozive, nëpërmjet ndërtimit ose ngritjes së disa veprave të veçanta antierozive, brenda një territori të caktuar, si pyllëzime, kanale të ujërave të larta, prita malore etj.;

c) përmirësimin e masave mbrojtëse të brigjeve të lumenjve, rrjedha e të cilave përshkon

territoret e dy ose më shumë qarqeve;

ç) programet dhe projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit ose donatorë, si dhe nga fondet e përbashkëta të disa njësive të qeverisjes vendore të krijuara sipas shkronjës "e" të nenit 10 të ligjit nr.9244, datë 17.6. 2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore";

d) veprimtarinë e përbashkët të dy ose më shumë ministrive në të njëjtën hapësirë të tokës bujqësore.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, KSHMT-ja merr vendimet përkatëse, të cilat u njoftohen

ministrive, institucioneve të tjera shtetërore, si dhe organeve të qeverisjes vendore.

3. KSHMT -ja shqyrton propozimet e organeve shtetërore dhe të strukturave pranë tyre për kalime dhe ndryshimet e gjendjes së tokave bujqësore, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", si dhe mbrojtjen në tërësi të tokës bujqësore nga ndërtimet e paligjshme.

4. KSHMT-ja analizon raportin 6-mujor me të dhënat e raportuara nga Komisioni i Mbrojtjes së Tokës në qark, për gjendjen e masave mbrojtëse e rehabilituese të tokave bujqësore, bën vlerësimin për punën e kryer nga të gjitha strukturat shtetërore të ngarkuara për mbrojtjen e tokës bujqësore.

5. KSHMT-ja për çdo rast, kur vëren moszbatim të detyrimeve, që rrjedhin nga dispozitat e akteve ligjore e nënligjore, u propozon marrjen e masave administrative për strukturat e veçanta, që kanë përgjegjësi ligjore për mbrojtjen e tokës, organeve përkatëse që i kanë në varësi.

6. KSHMT-ja merr vendime të detyrueshme për zbatim nga organet e tjera shtetërore që

ligji i ngarkon për mbrojtjen e tokës bujqësore edhe kur:

a) objekti i vendimit shtrihet për dy ose më shumë qarqe;

b) një komunë dhe/ose bashki parashtron vërejtje ose kundërshtime për vendimet që janë

marrë nga këshilli i qarkut dhe KMT-ja në qark dhe që kanë si objekt masat mbrojtëse për tokën bujqësore, brenda territorit të komunës dhe/ose bashkisë përkatëse;

c) organi i qeverisjes vendore nuk ka nxjerrë vendimin e vet në kohën e përshtatshme e të përcaktuar në aktet nënligjore ose vendimi që është nxjerrë, nuk rezulton i plotë. Në këtë rast njoftohet organi përkatës, që ka për detyrë nxjerrjen e vendimit.

KREU II

INSPEKTORATI SHTETËROR I MBROJTJES SË TOKËS (ISHMT)

1. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit krijohet ISHMT-ja, për kontrollin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në të gjithë territorin e vendit.

2. Inspektorati të kryesohet nga kryeinspektori dhe në përbërje të ketë specialistë me

profesion agronom ose inxhinier gjeodet.

3. ISHMT -ja ushtron kontrole të programuara dhe të rastit për veprimtarinë që kryejnë Komisioni i Mbrojtjes së Tokës dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qarqe, si dhe strukturat e tjera shtetërore, të ngarkuara me ligj për zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e tokës.

4. ISHMT-ja bën vlerësimin e punës së kryer nga këto struktura dhe i propozon KSHMT-së masa për përmirësimin e gjendjes dhe masa disiplinore e administrative për struktura dhe titullarë, që nuk kanë përmbushur detyrimet, që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore për mbrojtjen e tokës. Në përfundim të çdo kontrolli harton aktin e kontrollit, i cili u bëhet i njohur kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes së Tokës, kryetarit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës, kryetarëve të komunave dhe/ose bashkive ku është realizuar kontrolli.

5. ISHMT-ja grumbullon, përpunon dhe analizon të dhëna nga Komisioni i Mbrojtjes së Tokës dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qarqe, në bazë të të cilave përgatiten raportet 6-mujore dhe vjetore për KSHMT-në, si dhe raporte të veçanta për çështje konkrete, të kontrolluara drejtpërdrejt ose nëpërmjet Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

6. ISHMT-ja kontrollon mbajtjen e dokumentacionit teknik për mbrojtjen e tokës nga Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës dhe zërat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komuna, dhe/ose bashki.

7. ISHMT-ja bashkërendon punën, ndërmjet mbledhjeve të KSHMT-së, në fushën e veprimtarive për mbrojtjen e tokës dhe masave për rehabilitimin e tokave të dëmtuara, me struktura të tjera në varësi të Ministrisë së

Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të tjera dhe organeve të qeverisjes vendore, të ngarkuara për mbrojtjen e tokës.

8. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, nëpërmjet ISHMT-së, ka në varësi teknike Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në qark.

KREU III

KOMISIONI I MBROJTJES SË TOKËS (KMT) NË QARK

1. KMT-ja në qark drejtohet nga kryetari i këshillit të qarkut.

Përgjegjësi i Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (SAMT) të qarkut është njëkohësisht edhe sekretar i KMT-së në qark.

2. KMT-ja thirret në mbledhje me njoftim të kryetarit, jo më pak se një herë në tre muaj, por, për çështje të veçanta, mund të mblidhet në çdo kohë.

3. Sekretari i KMT -së dhe Inspektoratit Mbrojtjes së Tokës në qark përgatisin

dokumentacionin dhe materialet e mbledhjeve të KMT -së.

4. KMT-ja shqyrton dhe bashkërendon programet dhe projektet afatgjata, afatmesme dhe vjetore, që kanë si objekt:

a) përmirësimin e sistemit të kullimit dhe ujitjes në hapësirën e tokës bujqësore, që përfshihet brenda territorit të qarkut, kur me të lidhet veprimtaria e dy ose më shumë komunave dhe/ose bashkive;

b) përmirësimin e masave antierozive, nëpërmjet ndërtimit ose ngritjes së veprave të veçanta antierozive si pyllëzime, kanal e të ujërave të larta, prita malore e vepra të tjera, kur këto përfshihen në hapësira të tokave bujqësore të dy ose më shumë komunave dhe/ose bashkive;

c) përmirësimin e masave mbrojtëse të brigjeve të lumenjve, rrjedha e të cilëve përshkon territorin e dy ose më shumë komunave dhe/ose bashkive.

Për të gjitha çështjet e shqyrtuara për bashkërendim, KMT-në qark merr vendime përkatëse, që i dërgohen në formë rekomandimi këshillit të qarkut dhe këshillave të komunave.

Këshilli i qarkut dhe këshillat e komunave dhe/ose bashkive, pasi i shqyrtoi se këto vendime, mund t'i kthejnë në vendime të tyre, të detyrueshme për zbatim.

5. KMT-ja shqyrton propozimet e njësive të qeverisjes vendore për përdorimin e tokës bujqësore për zhvillime të ndryshme urbane mbi këtë hapësirë, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

6. KMT-ja analizon raportet e të dhënave 6-mujore të paraqitura nga zyrat e menaxhimit dhe mbrojtës së tokës, në komuna dhe/ose bashki dhe raportin e Seksionit të Administrimit të Mbrojtjes së Tokës për gjendjen, masat mbrojtëse dhe rehabilituese të tokës bujqësore, për të cilat merr edhe vendimet përkatëse.

7. KMT-ja përcakton çështjet e veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore, që do të verifikohen, kontrollohen ose studiohen nga grupet e kontrollit që krijon për këtë qëllim.

8. KMT-ja analizon, zbërthen dhe programon për qarkun vendimet e KSHMT-së, si dhe akte të tjera të ISHMT-së.

9. Të gjitha strukturat shtetërore, që funksionojnë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut detyrohen që, në çdo kohë, të vënë në dispozicion të grupeve të kontrollit punonjësit apo specialistët e tyre, sipas programit të miratuar nga kryetari i këshillit të qarkut, në cilësinë e

kryetarit të KMT -së në qark.

KREU IV

INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TOKËS (IMT) NË QARK

1. IMT -ja organizohet si sektor i veçantë pranë Seksionit të Administrimit të Mbrojtjes së

Tokës në qark.

Numri i punonjësve të T -së sipas qarqeve përcaktohet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet

këtij vendimi.

Ky numër të plotësohet, brenda muajit mars 2005, me specialistë me formim universitar në

degët e agronomisë, gjeodezisë dhe ekonomisë.

2. Punonjësi i emëruar në IMT cilësohet inspektor dhe pajiset me kartën (certifikatën) e inspektorit, të nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit. Drejtimi i këtij inspektorati bëhet nga kryeinspektori.

3. IMT-ja ka varësi teknike nga ISHMT-ja, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

4. IMT-ja programon punën vjetore të kontrollit të zbatimit të masave për mbrojtjen e tokës

bujqësore, për të gjithë territorin e qarkut, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi dhe vendimeve të strukturave shtetërore, eprore, të mbrojtjes së tokës si KSHMT -së, ISHMT -së dhe KMT-së së qarkut.

5. IMT-ja programon dhe ushtron kontrole:

a) metodike, të zakonshme, që organizohen dy herë në vit. Kontrolli i parë ushtrohet gjatë

muajve prill-maj, ndërsa kontrolli i dytë në muajt shtator-tetor.

b) operative për çështje e territore të veçanta, të cilat organizohen në vijimësi nga IMT-ja ose grupe të veçanta të ngritura me vendim të KMT-së, për të cilat ndiqet e njëjta procedurë si për kontrollin metodike, të zakonshme.

6. Objekt kontrolli janë masat për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore, si dhe

vendimet që janë marrë për to në periudhat pararendëse, për të gjitha komunat dhe/ose bashkitë në juridiksion të qarkut. Kontrolli bëhet në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

7. Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë ka për detyrë që grupit të kontrollit, për territorin përkatës, t'i caktojë si anëtarë specialistin e zyrës së menaxhimit të mbrojtjes së tokës dhe punonjës të tjerë të administratës së komunës/bashkisë, si dhe kryetarët e fshatrave dhe/ose administratorët e nënndarjeve të njësive administrative.

8. Në përfundim të kontrollit të të gjithë njësisë administrative, grupi i kontrollit harton aktin e kontrollit, ku përfshihen edhe të dhëna të tjera për kontrollin e ushtruar, përcakton detyrat dhe masat e veçanta që duhen marrë, të cilat ia paraqet kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë së kontrolluar.

9. Raporti përmbledhës në shkallë qarku për kontrollin e ushtruar i paraqitet kryetarit të këshillit të qarkut. Ky raport analizohet në mbledhjen e radhës së KMT-së në qark. Pas shqyrtimit, për çdo çështje të veçantë, merren vendime përkatëse.

10. Në të gjitha kontrollet, që ushtrohen nga IMT-ja, zbatimi i sanksioneve ligjore, të përcaktuara në kreun V të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", dokumentohet nëpërmjet procesverbalit tip. Formatit dhe mënyra e mbajtjes së procesverbalit tip, ndërmjet ushtruesve të kontrollit dhe subjektit të kontrolluar, miratohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

11. Grupet e kontrollit të IMT-së dhe grupet e veçanta të ngritura me vendim të KMT-së. shoqërohen nga forcat e Policisë së Shtetit të drejtorisë së policisë së prefekturës përkatëse, si dhe nga Policia Ndërtimore, që ushtron veprimtari në territorin e qarkut, sa herë që vlerësohet nga kryetari i këshillit të qarkut, me cilësinë edhe të kryetarit të KMT-së.

Kryetari i këshillit të qarkut kërkesën për angazhimin e forcave të Policisë së Shtetit dhe të

Policisë Ndërtimore, ua komunikon drejtuesve përkatës 3 ditë përpara fillimit të kontrollit.

12. IMT -ja mban regjistrin e mbrojtjes së tokës dhe dokumente të tjera, ku evidentohen

treguesit thelbësorë për gjendjen dhe masat mbrojtëse për tokën bujqësore.

13. IMT-ja, në bazë të të dhënave që rezultojnë nga kontrollet e ushtruara dhe të treguesve të tjerë që merr nga zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki, përgatit raportet përkatëse për KMT-në e qarkut, si dhe ISHMT-në në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

KREU V

1. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së

Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të këshillave të qarqeve, për vitin 2005, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet vendimit.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Mjedisit dhe institucione të

tjera të ngarkuara për mbrojtjen e tokës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja nr. 1

Numri i inspektorëve në IMT të qarqeve

Nr. Emërtimi i Qarkut Nr. Inspektorët gjithsej

1 Berat 3

2 Dibër 3

3 Durrës 3

4 Elbasan 4

5 Fier 4

6 Gjirokastër 3

7 Korçë 4

8 Kukës 3

9 Lezhë 3

10 Shkodër 3

11 Tiranë 3
12 Vlorë 4
Republika 40

Lidhja nr.2

Financimi i shpenzimeve për mbrojtjen e tokës për vitin 2005

Emërtimi i institucioneve

dhe i qarqeve Gjithsej

000/lek Nga kjo:

Personelit Shpenzimet

Nr. punonj. 000/lek

gjithsej operative kapitale

a b 1(3+4+5) 2 3 4 5

I Për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit 4800 4 3500 1300

II Për këshillat e qarqeve

(inspektorati i mbrojtjes së tokës), gjithsej ndarë sipas qarqeve 39 390 40 28

260 9930 1200

1 Berat 3110 3 2220 790 100

2 Dibër 3110 3 2220 790 100

3 Durrës 3110 3 2220 790 100

4 Elbasan 3800 4 2760 940 100

5 Fier 3800 4 2760 940 100

6 Gjirokastër 3110 3 2220 790 100

7 Korçë 3110 3 2220 790 100

8 Kukës 3110 3 2210 790 100

9 Lezhë 3110 3 2220 790 100

10 Shkodër 3110 3 2220 790 100

11 Tiranë 3110 3 2220 790 100

12 Vlorë 3800 4 2760 940 100

Totali (I + II) 44 190 44 31 760 11 230 1200

Copyright 2009 - www.ligjet.org